



KQZ  
U PROTOKOLLUA  
NR/3194/2012  
DATE 03.07.2012

AUDITUES LIGJORE  
ERVIS KRAJA

NR LICENSE 262 dt27/08/2012

**INFORMACION I AUDITUESIT LIGJOR TË PAVARUR  
MBI PASQYRAT FINANCIARE  
PARTIA LIBERALE SHQIPTARE**

Tirane

(Për periudhën 1 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2018)

Shkodër, 28 QERSHOR 2019



**INFORMACION I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; me adresë : Rruga "Ibrahim Rugova" Tiranë, Albania.

**PARTIA LIBERALE SHQIPTARE , OJF** me adresë: Tirane

**Informacion**

Ne nuk kemi kryer auditimin e pasqyrave financiare të Partisë: **PARTIA LIBERALE SHQIPTARE , OJF** me adresë: Tirane , me Perfaqesues Ligjor Z. Valter File .

Në pamundësi të sigurimit të evidencës nga **PARTIA LIBERALE SHQIPTARE** Ne nuk mundëm të shprehim **opinion**, mbi pasqyrat e pozicionin financiar të Partisë me datën 31 Dhjetor 2018, aktivitetet dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

**Baza për Informacionin**

Në pamundësi të sigurimit të evidencës nga **PARTIA LIBERALE SHQIPTARE** , Ne nuk mundëm të shprehim opinion. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e Informacionit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Partia në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se në pambundësi të sigurimit të evidencës së auditimit nuk mund të japim opinion (\*).

*(\*) Ne drejtim te **PARTIA LIBERALE SHQIPTARE** kemi dërguar shkresë zyrtare me postë me kthim përgjigje respektivisht:*

*- Më datën 15 Maj 2019 kemi dërguar shkresën, me adresë Tirane , me, Kodi i postimit RR 841 306 066 AA, për të cilën nga Posta Shqiptare na është kthyer përgjigja me datën 20 Maj 2017 me shenimin "adrese e pa sakte ", kodi i postimit në kthim RR 841 306 066 AA*



- Më datën 21 Maj 2019 kemi nisur nje email ne drejtim te personelit te KQZ per te na ndimuar per nje adrese te re dhe nuk kemi marre asnje pergjigje .

*Për shkresen tone është përdorur e njëjta adresë, e cila është marrë nga rregjistri i Partive Politike të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkangjitur kontratës të lidhur në mes Ekspertit Kontabël dhe K.Q.Z-së me nr 1366/1 dt.07.05.2019.*

*Bashkelidhim ketij Informacioni kopjet e shkresave të derguara.*

### **Informacione të tjera**

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të informojmë për këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të informuar.

### **Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Partisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Partinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të informacionit financiar të Partisë dhe saktësimin e adresës së Partisë.



**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një Informacion auditimi që përfshin Informacionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalltë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Shkodër, më 28 Qershor 2019

Ervis Kraja

Ervis Kraja  


AUDITUES LIGJORE